



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 72/25 prot.

Datë 20.05.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 681/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.05.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr. 516/2026, datë 20.04.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-61164-09-11-2025, me objekt: “Kryerje e shërbimit të Gjelbërimit në SUT” për një periudhë 36 mujore”, me fond limit 32,115,167.55 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Rej” SHPK, me NIPT J93711608Q, dhe adresë Rruga Dritan Hoxha, Ngjitur me Shkollën Ahmet Gashi, Kulla Jeshile, Nr.Pasuri 8/374 /ND+3-6, H, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara me adresë Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen

e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 20.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.516/2026 ku vendosi:

1. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Rej” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-61164-09-11-2025, me objekt: “Kryerje e shërbimit të Gjelbërimit në SUT” për një periudhë 36 mujore”, me fond limit 32,115,167.55 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.*
2. *Autoriteti kontraktues të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim duke e kualifikuar atë.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “Rej” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 2014/3 prot., datë 15.05.2026 protokolluar me tonën nr. 72/22 prot., datë 20.05.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.516/2026 datë 20.04.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. me Nr. REF-61164-09-11-2025, me objekt: “Kryerje e shërbimit të Gjelbërimit në SUT” për një periudhë 36 mujore”, me fond limit 32,115,167.55 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara, duke i bashkëngjitur shkresë procesverbalin e rivlerësimit të KVO datë 14.05.2026.

### **II**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### **Arsyeton:**

II.1 Me shkresën nr. 2014/3 prot., datë 15.05.2026 protokolluar me tonën nr. 72/22 prot., datë 20.05.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.516/2026 datë 20.04.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. me Nr. REF-61164-09-11-2025, me objekt: “Kryerje e shërbimit të Gjellbërimit në SUT” për një periudhë 36 mujore”, me fond limit 32,115,167.55 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara, duke i bashkëngjitur shkresës procesverbalin e rivlerësimit të KVO datë 14.05.2026.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera nga autoriteti kontraktor, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.516/2026 datë 20.04.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim, procesverbali i rivlerësimit të KVO datë 14.05.2026 dhe veprimeve të kryera në SPE rezultoi se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës object ankimi, në zbatim të vendimit Nr.516/2026 datë 20.04.2026, të këtij komisioni, duke kualifikuar operatorin ekonomik “Rej” SHPK.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të lejohet autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-61164-09-11-2025, me objekt: “Kryerje e shërbimit të Gjellbërimit në SUT” për një periudhë 36 mujore”, me fond limit 32,115,167.55 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

